



Republika e Kosovës * Republic of Kosova

Komuna * Municipality

Hani i Elezit



Date 24.03.2021

Nr.09/ 2234 /2021

KONTRATË FURNIZIMI

KOMUNA HANI I ELEZIT përfaqësuar nga **Zyra e Prokurimit** me Zyrtarin Përgjegjës Xhevdet Bushi, MSc. (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.T.G. "BLENDI" – **Prishtinë**, me NUI: **810446072** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), me drejtor **Shaip RAMA**, te cilin me autorizim e përfaqëson **Hasan Krasniqi** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për: "**Botimi i vjetarit 2020 dhe material shtypes (kese, banerë)**" me numër Identifikues: **KKHE- 21-001-136**

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë : "Botimi i vjetarit 2020 dhe material shtypes (kese, banerë)

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 26.03.2021 dhe përfundon me 06.04.2021.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëresës nga AK-ja.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve, dhe shërbimet e tjera sipas kërkeses së AK-së.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **2,660.00 €**; Dymijë e gjashtëqindë e gjashtëdhjetë Euro /00 cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës (artikujve në DT).

Pagesa do të bëhet sipas furnizimit që do të kryhen.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet më së shumti 30 ditë nga data e pranimit të faturës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **Furnizimeve/shërbimeve** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet të kërkuara e të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Në rast se të kundërtën nuk do të bëhet **pranimi i furnizimit/shërbimit**. Në rast se nuk bëhet shtypja e mire apo devijohen rreshtat apo gabim teknik në shkrim, nuk do të pranohet vjetari dhe materiali tjetër shtypës dhe nuk do të mbajmë asnjë përgjegjësi

Neni 7 Garancioni

7.1 **Ekzekutimi i kontratës do të jetë i siguar me sigurim të ekzekutimit të kontratës** nga data e nënshkrimit të kontratës dhe për çdo mos-kryerje të shërbimit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, do të detyrohemi njëanshëm të bëjmë shkëputjen e kontratës në fjalë dhe të marrim masat ligjore.

7.2. Sigurimi i ekzekutimit 10% e vlerës së kontratës për 30 ditë nga data e nënshkrimit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]** brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve/shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

8.2. Në rast se nuk kryhen furnizimi/shërbimi siç duhet dhe vie të defekti për shkak të problemeve nga kontraktuesi do të rregullohet nga ana e kontraktuesit në të kundërtën do të marrim masat ligjore.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. **Konform kryerjes së shërbimeve sipas furnizimit/shërbimit do të bëhet pagesa. Në rast se nuk kryhet shërbimi sipas kërkesës së AK-së, do të merren masat sipas Ligjit në fuqi, ku kontraktuesi do të bartë të gjitha shpenzimet dhe do të merren masa konform LPP-së.**

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti

Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

11.2 Në rast se nuk kryhen shërbimet sipas pikave të shënuara në këtë kontratë do të marrim masa sipas ligjit dhe do të shkeputet kontrata

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykata kompetente** në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **[Shqipe]**² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Hasan Krasniqi	Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Perfaqësues me autorizim	Pozita:	Shef i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.03.2021	Data:	24.03.2021
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.